<http://www.herbmed.org>

Ndërveprimet midis barnave dhe suplementëve bimorë ose ushqimorë janë më të shpeshta seç mendohet dhe mund të ketë pasoja të rëndësishme, për këtë arsye nuk duhet nënvlerësuar kurrë rreziku i terapive shoqëruese. Disa bimë dhe disa suplementë ushqimorë mund të shkaktojnë

efekte të rënda anësore nga ndërferimi me barnat që pacienti është duke marrë nën këshillën e mjekut.

Megjithëse suplementet ushqimore janë përgjithësisht të sigurta kur përdoren siç duhet, ekziston potenciali për shfaqjen e efekteve të padëshiruara. Profesionistët e kujdesit shëndetësor luajnë një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimit të pacientit në lidhje me rreziqet e mundshme që lidhen me përdorimin e suplementeve shtesë. Pacientët që zgjedhin të përdorin suplemente ushqimore duhet të këshillohen dhe ndërgjegjësohen që këto suplemente nuk e zëvendësojnë dietën e përditshme të ekuilibruar.

Për një përdorim të sigurt të suplementeve ushqimore këshillojmë gjithashtu, zbatimin e një serë rekomandimesh nga të gjithë përdoruesit e tyre, si më poshtë:

1. Merrni informacione të sakta!

Të paturit njohuri mbi këto ndërveprime është arma më e mirë për tu mbrojtur ndaj tyre. Pacienti duhet të dije çfarë po përdor dhe pse. Për këtë është e rëndësishme që barnat të mbartin në çdo rast emrat dhe sasi të substancave përbërëse, arsyet e përdorimit, dobitë e pritshme, por edhe efektet anësore të mundshme. Duhet shmangur “formulat e fshehta”. Fatkeqësisht, mungesa e njohurive për ndërveprimet e mundshme midis suplementeve ushqimore/bimore dhe barnave si dhe mënyra e ndryshme si ato veprojnë mbi individë të ndryshëm, e bën të vështirë identifikimin e tyre. Për këtë arsye, është i rëndësishëm në çdo kohë bashkëpunimi me mjekun, farmacistin ose personelin mjekësor, për t’u siguruar që çdonjëri prej tyre të jetë në dijeni për të gjitha substancat që përdoren, për të marrë kështu informacionin e nevojshëm dhe për të bërë zgjedhjet e duhura.

2. Komunikoni me profesionistët e shëndetit!

Vini në dijeni farmacistin dhe mjekun tuaj edhe për bimët dhe suplementet shtesë ushqimore që ju përdorni. Projekti i informimit sugjeron përdorimin e “Çantës kafe të informimit mbi medikamentet”. Vendosni të gjithë medikamentet që ju përdorni, duke përfshirë edhe barnat OTC si dhe produktet shtesë si bimët mjekësore dhe suplementet ushqimore, në një çantë dhe merreni atë me vete në çdo punonjë të shëndetësisë ku shkoni në mënyrë që ata t’iu këshillojnë

në lidhje me to. Bëni një listë të të gjithë bimëve mjekësore dhe suplementeve që ju përdorni dhe tregojani atë mjekut tuaj sa herë është e nevojshme. Informacione të reja po publikohen çdo ditë e më shumë në literaturat mjekësore dhe farmaceutike prandaj mjeku apo farmacisti juaj do të dijë t'iu informojë në lidhje me ndërveprimet e mundëshme midis barnave zyrtare, fitopreparateve dhe barnave të tjerë sintetikë.

3. Ndiqni me përpikmëri keshillat e mjekut/farmacistit!

Filloni konsumimin e një preparati në një kohë të caktuar dhe mos e përdorni atë në doza më të mëdha se ata të rekomanduara. Shmangni kombinimet e suplementeve ushqimore të cilat përmbajnë shumë përbërës.

4. Shënoni gjithçka që ka lidhje me menyrën e trajtimit me barna!

Mbani një ditar në lidhje me çdo përgjigje që ju shfaqni ndaj një trajtimi që nisni dhe mos vazhdoni ta përdorni për më shumë se disa javë nëq nuk merrni efektin e dëshiruar. Ulja e numrit të suplementeve ushqimore që ju përdorni, ul njëkohësisht edhe riskun e ndërveprimeve.

5. Blini suplemente ushqimore të sigurt!

Blini suplemente ushqimore tek një prodhues i njohur dhe i besueshëm, ose në dyqane që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre për një kohë të gjatë. Pyesni punonjës të shëndetësor në menyre që t'iu drejtojnë tek një burim i sigurtë dhe t'iu rekomandojnë një preparat bimore me cilësi të lartë. Produktet e prodhuesve jo të besueshëm mund të kenë përmbajtje variable (jo korrekte) të përbërësve të një preparati bimore, cilësi jo të mirë ose mund të jenë të kontaminuar nga ingredientë të tjerë. Ju nuk mund të dini apo të parashikoni një ndërveprim n.q.s nuk dini me saktësi çfarë përmban produkti.

6. Mbroni fëmijët!

Përdorni suplemente ushqimore të fëmijët vetëm pasi të jeni konsultuar me një profesionist shëndeti. Fëmijët janë më të prirur për të shfaqur efekte anësore si pasojë e metabolizmit të ndryshueshëm që ata kanë. Shmangni përdorimin e bimëve mjekësore nëq jeni shtatzënë ose po

planifikoni të jeni. Disa bimë mund të shkaktojnë lindje të parakohshme ndërsa të tjera mund të ulin tonusin e uterusit.

7. Zbatoni kohën e administrimit bar-suplement!

Meqenëse informacioni që ne kemi në lidhje me ndërveprimet barna-suplemente është i limituar për shkak të absorbimit të ndryshueshëm që shfaqin këto të fundit, përpiquni të ndani marrjen e barnave dhe suplementeve me një kohëzgjatje minimalisht të paktën prej një orë.

8. Përdorni me mase suplementet ushqimore!

Fakti që është natyrore nuk do të thotë se është e padëmshme. Shumë njerëz pohojnë se meqenëse marrin preparate “natyrore” nuk ka vend për shfaqje të efekteve anësore prej tyre dhe se dozat e rekomanduara janë një element i cili nuk duhet marr shumë në konsideratë. Megjithatë ka një serë efektsh anësore dhe toksike që mund të shfaqen prej bimëve. Shmangni përdorimin e bimëve mjekësore të cilat kanë efekte toksike të njohura. Psh. pacientët e infektuar me HIV duhet të shmangin përdorimin për një kohë të gjatë të Echinacea, sepse ajo mund të rris shkallën e replikimit të virusit të HIV-it.

9. Përdorni llogjikën dhe arsyen!

Preparatet më të shtrenjta nuk janë gjithmonë më të mirat, prandaj zgjedhja e nje suplementi ushqimor/bimor realizohet duke u bazuar fillimisht ne kritere te tjera te rendesishme per shendetin.

Tema 14

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në përdorimin e suplementeve

Gjatë 20 viteve të fundit, përdorimi i suplementeve ushqimore është rritur shumë globalisht. Si pasojë e krizës së shëndetit publik që erdhi si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe frikës që popullata shfaqti në lidhje me vaksinat COVID-19 si dhe furnizimit të tyre jo të mjaftueshëm në shumë rajone të botës, u vu re një rritje e interesit mbi përdorimin e suplementeve ushqimore si një mjet alternativ jo vetëm për t'u mbrojtur nga ky virus por edhe për trajtimin e sëmundjeve shoqeruese që shkaktohen si rezultat i tij. Pavarësisht mungesës në prova mbi efikasitetin e këtyre suplementeve, një rritje në shitje e suplementeve ushqimore është raportuar në shumë shtete të botës.

Shumë pyetje janë ngritur për diskutim në lidhje me efektet terapeutike që lidhen me suplementet ushqimore për shkak të përdorimit të shtuar të tyre gjatë krizës shëndetësore. Studime të shumta shkencore kanë demonstruar jo vetëm efektet e tyre të dobishme por dhe disa efekte negative dhe madje toksike.

Pandemia COVID-19, e shkaktuar nga koronaviirusi u përhap në gjithë botën dhe vazhdon ende të frikësojë një pjesë të madhe të popullsisë si pasojë e prekjes së organeve të shumta nëpërmjet mekanizmave imunologjikë, inflamatorë etj. Përdorimi i suplementeve ushqimore, të tilla si vitaminat dhe mineralet, të cilat mund të ofrojnë njëfarë mbrojtjeje duke forcuar sistemin imunitar dhe duke ndihmuar në uljen e ashpërsisë së sëmundjes është vënë në dukje si një trajtim ndihmës ose terapeutik për COVID-19.

Pavarësisht zhvillimit të disa vaksinave për COVID-19 dhe disponueshmërisë së shumë terapive farmakologjike, kërkesa për suplemente ushqimore gjatë pandemisë COVID-19 është rritur ndjeshëm në mbarë botën. Gjatë 20 viteve të fundit, ka pasur një rritje të konsiderueshme në prevalencën e përdorimit të suplementeve. Në fakt, tregu i suplementeve ushqimore po rritet për sa i përket shitjeve dhe më e rëndësishmja, për sa i përket produkteve të disponueshme në treg.

Konsumatorëve çdo ditë ju prezantohen nëpërmjet llojeve të ndryshme të marketingut një numër i madh produktesh, firmash farmaceutike dhe formulimesh. Vlera e tregut global të suplementeve ushqimore ishte rreth 152 miliardë dollarë në vitin 2021.

Tregu global për suplemente ushqimore karakterizohet aktualisht nga një rritje e vazhdueshme e shitjeve, duke konfirmuar besimin se ato janë një pjesë e rëndësishme e dietave të njerëzve në mbarë botën. [8]. Sipas studimeve rezultoi se shitjet e suplementeve ushqimore u rritën ndjeshëm në fillim të vitit 2020 si rezultat i pandemisë COVID-19 [9]. Rezultoi se shitjet u rritën me 50% midis viteve 2018 dhe 2020, dhe vlera e tyre tejkaloi shifrën 220 miliardë dollarë në vitin 2020 [10]. Sipas raportit të fundit të STASTICA, tregu global pritet deri në vitin 2028 të arrijë vlerën prej 300 miliardë dollarë [7].

Ndërkohë që tregu i suplementeve ushqimore është rritur dhe është bërë më fitimprurës, një rëndësi e vecantë i jepet sigurimit të cilësisë së produktit, si dhe sfidave që lidhen me të.

Për këtë arsye, kërkesa për plotësimin e standardeve globale të cilësisë dhe fokusimi i shtuar në sfidat rregullatore që lidhen me suplementet ushqimore janë të nevojshme, pasi produktet e falsifikuara ose të etiketuara gabimisht mund të mos i nënshtrohen kontrollit nga rregulloret ekzistuese, duke çuar në një rritje të incidencës së reaksioneve anësore (nga të cilat disa mund të jenë fatale) të shkaktuara nga substanca të padëshiruara të ndodhura në produkt në vend të principit aktiv [11].

Në ndryshim nga barnat, ligjet mbi rregullimin e suplementeve ushqimore janë më pak të zhvilluar dhe legjislacioni nuk konsiderohet shumë strikt [12]. Për më tepër, aktualisht ekzistojnë pak marrëveshje midis shteteve të ndryshme mbi legjislacionin për kërkesat rregullatore, përkufizimin e suplementeve ushqimore apo edhe terminologjinë që mund të përdoret për të klasifikuar suplementet ushqimore [13]. Prandaj me qëllim për të mbrojtur konsumatorin shumë vende kanë vendosur rregullore që rregullojnë prodhimin, importimin dhe shitjen e suplementeve ushqimore. Kështu, që nga dizajni deri te marketingu, prodhuesit, importuesit dhe shitësit kanë një kuadër të qartë ligjor brenda të cilit duhet të operojnë, duke kontribuar drejt arritjes së një niveli të lartë sigurie dhe mbrojtjes të shëndetit të konsumatorit. [6].

Konteksti brenda të cilit përdoren suplementet ushqimore ndryshon gjerësisht nga shteti në shtet dhe këto produkte rregullohen nga disa agjenci federale dhe rregullore qeveritare të cilat sipas ligjit mund të heqin një produkt nga tregu për shkak të kontaminimit, keqidentifikimit, falsifikimit, etiketimit të gabuar apo pretendimeve të rreme, mbikëqyrjes pas marketingut, shfaqjes së efekteve të padëshiruara dhe mosrespektimit të standardeve të mira të prodhimit [14]. Pengesat e shumta që lindin mbi rregullimin e suplementeve ushqimore mund të rezultojnë në implikime serioze negative për shëndetin publik, të tilla si vlerësimi joadekuat i sigurisë, kërkesat e pamjaftueshme të efikasitetit, monitorimi i dobët i pretendimeve të paargumentuara të etiketimit dhe marketingut, sigurimi dhe kontrolli joadekuat i cilësisë dhe boshllëqet e lindura në kuadrin rregullator pas marketingut. Si rezultat, potenciali për dëmtim nga përdorimi i suplementeve ushqimore mund të variojë nga humbja monetare deri te efektet serioze të dëmshme shëndetësore. [15].

Suplementet ushqimore shpesh blihen legalisht për të përmbushur nevojat e ushqimore të individëve të caktuar, por disa individë furnizohen në mënyrë të paligjshme, gjë që rrit rrezikun e falsifikimit dhe i bën ato edhe më të rrezikshme. Megjithatë, për marrjen e këtyre suplementeve nuk kërkohet një recetë, një profesionist shëndeti duhet të rekomandojë dhe mbikëqyrë përdorimin e tyre [16].

Shqetësimet në lidhje me përdorimin e suplementeve dietike përfshijnë faktin se ato janë "të aprovuara" dhe se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur përdorimin e tyre të gjerë. Ekziston një nevojë kritike për informacion të besueshëm mbi përdorimin e tyre.

14.1 Tendanca në përdorimin e suplementeve ushqimore para dhe gjatë shfaqjes së pandemisë COVID-19

Vitet e fundit është rritur shumë shqetësimi i konsumatorëve për shëndetin e tyre për shkak të zhvillimit të shpejtë të njohurive mjekësore shoqërore dhe standartit të jetesës. Për më tepër, shfaqja e pandemisë së koronavirusit ka rritur ndërgjegjësimin e të gjithëve për rëndësinë e shëndetit dhe nevojën për të ruajtur shëndetin. Kjo sëmundje infektive ka pasur një ndikim të

rëndësishëm në stilin e jetesës dhe ekonominë globale, prandaj, gjetja e mënyrave për të luftuar ose zbutur efektet e kësaj sëmundjeje ka qënë e domosdoshme.

Duke qënë se suplementet ushqimore kanë rezultuar të kenë përfitime specifike shëndetësore dhe/ose potencial për të përmirësuar shëndetin, përdorimi i tyre ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e konsumatorëve. Përdorimi i një diete të shëndetshme dhe suplementeve ushqimore kanë rezultuar shumë ndihmës në menaxhimin dhe parandalimin e COVID-19. Sipas studimeve ka rezultuar se përdorimi i disa suplementeve kryesisht me përmbajtje vitaminën C, D dhe B, zinkun dhe probiotikët ka ndikuar në përmirësimin e imunitetit.[45,46](#)].

FDA i trajton suplementet ushqimore si ushqime dhe i njëkohësisht i konsideron ato si ilaçe. Ndryshe nga barnat me recetë, nuk është e detyrues të provohet që ato të jenë të sigurta ose efektive përpara se të vihen në dispozicion komercialisht. Edhe pse suplementet në treg merren në forma të ndryshme (kapsula, tableta, pluhur, lëng, etj.), ato rrjedhin nga burime natyrore dhe synojnë të rrisin imunitetin ndaj sëmundjeve të tilla si infeksionet virale, inflamacionet dhe komplikimet e frymëmarrjes dhe më së shpeshti, ato përdoren si trajtime ndihmëse ose aditivë përpos marrjes së një ilaçi kryesor farmakologjik [\[4,47\]](#).

14.2 Karakteristikat e konsumit të suplementeve ushqimore

Shitjet e suplementeve ushqimore u rritën gjatë pandemisë për shkak të efekteve të tyre të perceptuara si "nxitëse në rritjen e imunitetit". Megjithatë njohuritë mbi efikasitetin e këtyre suplementeve ushqimore kundër koronavirusit ose sëmundjeve shoqëruese që ai shkakton janë shumë të pakta [\[9\]](#).

Studime të shumta kanë hetuar lidhjen midis përdorimit të llojeve të ndryshme të suplementeve ushqimore dhe rrezikut të COVID-19. Sipas këtyre studimeve ka rezultuar se ka një tendencë të rritjes së përdorimit të suplementeve ushqimore gjatë pandemisë [\[10,48,49,50,51\]](#). Gjithashtu sipas këtyre studimeve ndërseksionale, ka rezultuar se prevalenca e përdorimit të suplementeve lidhet me disa faktorë, të tillë si faktoret socio-demografik, karakteristikat shëndetësore dhe të stilit të jetesës, ndryshimet në arsyt e përdorimit të suplementeve ushqimore dhe ndryshimet në llojin dhe rrethanat e përdorimit të tyre.

Rritja e përdorimit të suplementeve ushqimore gjatë pandemisë është raportuar në disa studime të paraqitura në tabelën më poshtë (Tabela 5). Gjatë pandemisë COVID-19, u vu re një rritje prej 40% në konsumin e vitaminës C [51], 82% rritje në konsumin e multivitaminave [50], dhe 23% rritje në marrjen globale [49]. Dallimet në prevalencën e përdorimit të këtyre produkteve lidhen me nivelin socio-ekonomik të secilit vend, nivelin e njohurive për përfitimet dhe dëmet e këtyre suplementeve në popullata të ndryshme, dhe ndikimin e mediave [10,49].

Tabela 5

Prevalenca e suplementeve ushqimore më të përdorura para dhe gjatë pandemisë COVID-19.

	Para Pandemisë (%)	Gjatë pandemisë (%)	Lloji i Studimit	Vendi	Referencat
<i>Vitaminat</i>	27.7	58.0			
Vit. D	7.1	22.4			
Vit. C	19.8	53.1			
<i>Mineralet</i>	18.4	50.0			
Zinku	4.6	44.9	Ndërsektorial (pyetësor online)	Algjeria	[49]
Magnezi	11.5	18.9			
Seleni	0.8	6.1			
<i>Të tjerët</i>	9.0	12.6			
Omega 3	4.2	9.7			
<i>Vitaminat</i>					
Vit. D	34.6	35.1	Ndërsektorial (bazuar në pyetësor)	Arabia Saudite	[51]
Vit. C	48.8	68.4			
<i>Vitaminat</i>					
Vit. D	20.6	18.7	Ndërsektorial (anketë në internet)	Arabia Saudite	[50]
Vit. C	12.5	14.9			

	Para Pandemisë (%)	Gjatë pandemisë (%)	Lloji i Studimit	Vendi	Referencat
Multivitamina	24.6	44.9			
<i>Mineralet</i>					
Zinku	1.3	4.6			
<i>Vitaminat</i>					
Vit. D	35.5	41.0			
Vit. C	35.3	42.1			
Vit. E	15.2	17.5	Ndërsektorial (anketë në internet)	Libani	[48]
<i>Mineralet</i>					
Zinku	18.8	29.3			
<i>Vitaminat</i>					
Vit. D	10.7	5.5			
Vit. C	14.2	41.1			
<i>Mineralet</i>					
Kalciumi	0.2	0.2	Tërthor	Turqia	[52]
Zinku	0.2	-			

14.3 Konsumi i Suplementeve Sipas Statusit Pandemik

COVID-19 ndikon në sistemin imunitar, duke shkaktuar një përgjigje inflamatore sistemike ose sindromën e çlirimit të citokinës. Nivele të larta të citokineve dhe kemokineve pro-inflamatore janë gjetur në pacientët me COVID-19 [53]. COVID-19 shoqërohet gjithashtu me zhvillimin e mikrotrombeve dhe koagulopatisë, të cilat më vonë mund të çojnë në sindromën e shqetësimit akut të frymëmarrjes dhe infeksione dytësore [9,54].

Gjatë pandemisë COVID-19, u testuan disa vaksina dhe ilaçe për efikasitetin, sigurinë dhe dozën, për të cilat u desh një kohë e gjatë për t'u vërtetuar. Supplementet ushqimore ju ofrojnë pacientëve një opsion premtues si trajtim parandalues. Këto produkte mund të ndihmojnë në forcimin e sistemit imunitar dhe në shtypjen e mëtejshme të hiper-inflamacionit, duke ofruar mbështetje profilaktike dhe terapeutike kundër COVID-19. [4,55].

Shumë përpjekje kërkimore nga ana e shkenctarëve i janë kushtuar shpjegimit të rolit të suplementeve ushqimore në parandalimin dhe menaxhimin e infeksionit COVID-19.

Përdorimi i suplementeve ushqimore, të tilla si suplementet me vitamina dhe minerale, është shfaqur si një qasje e supozuar ushqyese ose trajtim ndihmës për COVID-19.

Plotësimi me vitamina dhe minerale është thelbësor gjatë COVID-19 për të zvogëluar ashpërsinë e simptomave dhe për të shkurtuar kohëzgjatjen e infeksionit të frymëmarrjes, duke përmirësuar kështu përgjigjet imune. Ka raporte kërkimore që tregojnë një interes në rritje për suplementet ushqimore kryesisht me vitaminat (C, A, E dhe D), me zink, omega-3, probiotikë, selenium etj. gjatë pandemisë COVID-19. (Tabela 5) [10,46]. Përveç kësaj, disa autorë në studimet e tyre kanë theksuar se suplementet me vitaminë C dhe D dhe zink ishin ato që përdorshin më së shpeshti për të rritur imunitetin dhe për të zvogëluar infektimin nga COVID-19. [6,56].

Duke pasur parasysh mungesën e terapive specifike për infeksionin COVID-19, rekomandimet mjekësore kanë promovuar idenë se disa vitamina, veçanërisht vitamina C dhe D janë elementët më efektivë për parandalimin dhe trajtimin e COVID-19.

Ka rishikime dhe studime të shumta që diskutojnë rolin e vitaminave (veçanërisht C dhe D) kundër transmetimit të COVID-19 (Tabela 6).

Në të vërtetë, vitamina D është vlerësuar dhe më përpara për vetitë e saj imunomoduluese, antiinflamatore, antioksiduese dhe antivirale. [55,57].

Vitamina D, një hormon sekosteroid, mendohet se është në gjendje të reduktojë rrezikun e infektimit nga COVID-19 gjatë periudhës së tij kritike duke stabilizuar barrierat fizike, duke rregulluar sistemin reninë-angiotensinë dhe duke rritur imunitetin qelizor të lindur dhe adaptiv. [58]. Cangiano etj. [59] ekzaminoi shkallën e vdekshmërisë pas përhapjes së COVID-19 në 157 banorë të një shtëpie pleqsh në Itali dhe raportoi se shkalla e vdekshmërisë ishte në përpjesëtim të kundërt me plotësimin e vitaminës D. Sipas një studimi grupor nga D'Avolio et al. [60],

nivele dukshëm më të ulëta të 25-hidroksivitaminës D (25(OH)D) u gjetën te pacientët me SARS-CoV2 PCR-pozitiv krahasuar me pacientët negativë. Për më tepër, roli i vitaminës D në reduktimin e rrezikut të COVID-19 është konfirmuar në disa studime vëzhguese dhe prova klinike. Prandaj, marrja e vitaminës D duhet të rekomandohet gjatë COVID 19 sidomos në pacientët me mungesë të vitaminës D [[61](#),[62](#),[63](#),[64](#)].

Vitamina C ka rezultuar gjithashtu si një vitaminë e përdorur shumë gjatë COVID-19. Në të vërtetë, vitamina C është një kandidat potencial terapeutik për parandalimin dhe trajtimin e infeksionit COVID-19, si dhe një terapi shtesë në kujdesin intensiv gjatë COVID-19 për shkak të historisë së saj të gjatë të përdorimit kundër ftohjes së zakonshme dhe infeksioneve të tjera të frymëmarrjes si dhe shumë vetive të dobishme (anti-inflamatore, imunomoduluese, antioksiduese, antivirale dhe antitrombotike) [[4](#),[9](#)]. Kjo vitaminë ndikon si në sistemin imunitar të lindur ashtu edhe në atë adaptiv dhe ka aktivitet të drejtpërdrejtë virucidal.

Për sa i përket fazës kritike të koronavirusit COVID-19, vitamina C ndihmon në kontrollin dhe reduktimin e citokinave, mbron endotelin nga dëmtimi oksidativ dhe është thelbësore për

përmirësimin indor. [65]. Sipas disa studimeve janë raportuar rezultate klinike të përmirësuara pas trajtimit me vitaminë C, kryesisht të lidhura me qëndrimet më të shkurtra në spital dhe përmirësim më të shpejtë të simptomave. [66].

Tabela 6 Suplementet dietike më të njohura për parandalimin e COVID-19.

Suplementet ushqimore më të përdorur (%)	Vit. D	39.0	55.7	15.3	31.6	49.1	60.2	50.1	52.5	31.1	30	22.4
	Vit. C	19.4	77.8	11.4	84.5	26.6	31.4	30.1	27.0	-	-	23.0
	Vit. B	-	14.1	9.1	9.4	-	-	-	-	-	-	6.2
	Multivitamina	27.4	21.9	16.6	17	43.9	58.3	41	-	-	14	12.6
	Zinku	15.8	42.9	5.7	8	12.4	13.4	17.8	17.4	1.8	9	30.4
	Seleni	-	19.3	-	-	-	-	-	13.1	-	-	2.5
	Omega 3	81.9	-	8.6	11.7	22.4	26.8	22.6	25.0	-	-	25.5
	Probiotik	22.3	-	4	4.4	11.6	22.5	12.8	4.5	20.9	-	-
Vendi	Turqia	Lindja e Mesme	Turqia	Emiratet e Bashkuara Arabe	MB	SHBA	Suedia	Polonia	Polonia	Teherani	Egjipti	
Numri i pjesëmarrësve	550	2100	488	2060	372.720	45.757	27,373	3274	935	510	400	
Lloji i Studimit	Tërthor	Ndërsektorial (anketë në internet)	Tërthor	Kërkim ndërsektorial	Sondazhi i komunitetit i bazuar në aplikacione			Ndërsektorial (anketë në internet)	Anketa (pyetësor)	Kërkim ndërsektorial	Ndërsektorial	
Referencat	[67]	[6]	[68]	[69]	[46]			[10]	[70]	[71]	[72]	

Disa autorë kanë rekomanduar plotësimin oral me 1-2 g/ditë vitamina për të lehtësuar kalimin e fazës kritike të COVID-19. [73].

Një raport i hulumtimit klinik në SHBA zbuloi nivele të ulëta serike të vitaminës C dhe D në shumicën e pacientëve me COVID-19. Sipas studimeve ka rezultuar se moshë më e madhe dhe nivelet e ulëta të vitaminës C janë faktorë rreziku të lidhur me vdekshmërinë [74].

Zinku

Nga të gjitha suplementet minerale të studiuara, zinku është paraqitur si një element kryesor profilaktik dhe terapeutik kundër SARS-CoV-2. Zinku është një mineral kyç gjurmë që është thelbësor për përgjigjet imune të lindura dhe të fituara ndaj infeksionit viral. Ai është gjithashtu i përfshirë në shumë procese biologjike të cilat lidhen me imunitetin [53]. Në fakt, zinku kontribuon në aktivizimin e përgjigjes imune antivirale duke stimuluar sintezën e citokineve pro-inflamatore, duke përfshirë interferonin dhe reaktantët e fazës akute si dhe duke nxitur përhapjen e qelizave të përfshira në sistemin imunitar të lindur dhe adaptiv. [75]. Prandaj, suplementet me hekur mund të përdoren si plotësues në trajtimin e COVID-19 përmes mekanizmave të ndryshëm, duke ofruar mbështetje thelbësore në lidhje me imunitetin individual, duke penguar replikimin e SARS-CoV-2 ARN dhe duke parandaluar hyrjen e virusit në qeliza. Zinku mund të ndihmojë gjithashtu në zvogëlimin e përgjigjes së ekzagjeruar inflamatorë, rrezikut të pneumonisë dhe reduktimin e kohëzgjatjes së sëmundjes. [76,77].

Sipas një studimi vëzhgues u zbulua se nivelet e zinkut ishin dukshëm më të ulëta në pacientët me COVID-19 sesa në pacientët e shëndetshëm dhe se këta pacientë kishin më shumë gjasa të kishin komplikime dhe qëndrime më të gjata në spital sesa pacientët me COVID-19 me mungesë zinku [78]. Në një studim tjetër, mostrat e marra nga pacientët me COVID-19 që ndërruan jetë u paraqitën me nivele më të ulëta të zinkut në plazmë sesa ato të marra nga pacientët që i mbijetuan virusit. [79]. Një dozë e lartë marrje e zinkut oral rezultoi në rikuperim klinik dhe përmirësim të oksigjenimit tek pacientët me COVID-19. [80].

Ka prova të mjaftueshme që provojnë se përdorimi i suplementeve ushqimore mund të jetë një strategji e mirë për të ndihmuar në reduktimin e efekteve negative të COVID-19.

Megjithatë, disa suplemente ushqimore mund të mos i jenë nënshtruar kontrollit të duhur nga autoritetet dhe konsumatorët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj informacioneve mashtruese dhe premtimeve të rreme që i rrethojnë. Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht gjithçkaje duhet të

kërkohet këshilla mjekësore përpara marrjes së suplementeve në mënyrë që të reduktohen efektet negative nga përdorimi i tyre. Marrja e tepërt e vitaminave dhe mineraleve mund të shkaktojë efekte negative dhe madje toksike dhe çrregullime të traktit gastrointestinal. Ndërveprimet ndërmjet suplementeve dhe barnave janë një çështje tjetër e cila duhet të merret parasysh kur diskutojmë për rritje të toksicitetit nga suplementet dhe ndikimit në efikasitetin e barnave.

Tabela 7

Përfitimet shëndetësore dhe mekanizmat e suplementeve ushqimore që përdoren më gjerësisht për të luftuar infeksionin SARS-CoV-2.

Vitamine, mineral	Përfitimet shëndetësore	Mënyra e veprimit kundër SARS-CoV-2	Referencat
Vit. D	Mbështet sistemin imunitar; rol imunomodulues, antiinflamator dhe anti-infektiv	Ulja e sindromës ‘storm’ së citokinës; Nxit prodhimin e katelicidinës dhe defensinave, gjë që redukton mbijetesën dhe riprodhimin e virusit; Rritja e nivelit të enzimës 2 konvertuese të angiotenzinës (ACE2) të tretshme, duke penguar hyrjen e virusit në qeliza; Rritja e nivelit të enzimës 2 konvertuese të angiotenzinës (ACE2), të tretshme duke penguar hyrjen e virusit në qeliza; Parandalimi i akumulimit të angiotenzinës II dhe	[81,82,83,84,85]
Vitamine, mineral	Përfitimet shëndetësore	Mënyra e veprimit kundër SARS-CoV-2	Referencat

		<p>zvogëlimi i aktivitetit të saj pro-inflamator;</p> <p>Redukton rrezikun e dëmtimit të indeve/organeve të ndryshme, si dhe vdekshmërinë</p>	
Vit. C	Antioksidant, anti-inflamator, antiviral, imunomodulues dhe antitrombotik	<p>Rregullimi epigjenetik i gjeneve të ndryshme (rregullimi i proteinave antioksidante, rregullimi i ulët i citokinave pro-inflamatore në vend të pastrimit të drejtpërdrejtë të oksidantëve);</p> <p>Kunder veprimin e citokinave pro-inflamatore, veçanërisht IL-6;</p> <p>Redukton shënuesit inflamatorë si ferritina dhe Ddimeri dhe zbut aktivizimin e tepërt të përgjigjeve imune;</p> <p>Ul nivelin e D-dimerit, i cili është një tregues i rëndësishëm i formimit të trombit;</p> <p>Parandalon hiperaktivizimin e qelizave imune;</p> <p>Ndalon ngjarjet e shkaktuara nga citokina, përmirëson funksionin pulmonar dhe zvogëlon rrezikun e sindromës së shqetësimit akut të frymëmarrjes.</p>	[4,9,65,86]
Zinku	Veti imunomodulues dhe antivirale	<p>Frenon kompleksin e sintezës, replikimit dhe transkriptimit të koronavirusëve;</p> <p>Ndalon ngjarjet e shkaktuara nga citokina; pengon hyrjen e SRAS-CoV-2 në qelizën pritëse;</p> <p>Zvogëlon dëmtimin e organeve dytësore ndaj</p>	[53,75,76,77,79,87]

Vitamine, mineral	Përfitimet shëndetësore	Mënyra e veprimit kundër SARS-CoV-2	Referencat
përgjigjes inflamatore ndaj SARS-CoV-2.			

14.4 Tregu për suplementet ushqimore në vendet prodhuese dhe konsumatore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19

Suplementet ushqimore shpërndahen përmes disa rrugësh, ku përmendim rrugët e shpërndarjes ‘offline’ si farmacitë, supermarketet, dyqanet e specializuara, shitësit e pavarur etj.


Për shkak të popullaritetit të tyre më të madh, supermarketet dhe hipermarketet përbëjnë afërsisht 33,9% të të gjitha shitjeve të suplementeve ushqimore nëpërmjet rrugëve ‘offline’ në vitin 2021.

Rrugët ‘offline’ në total dominojnë tregun, duke zënë 81,0% të shitjeve totale, pasi janë lehtësisht të aksesueshme [88]. Sidoqoftë, interneti, komunikimet celulare dhe mediat sociale kanë krijuar rrugë të reja komunikimi të bazuara në teknologji, të njohura si "kanale dixhitale" ose "kanale elektronike", të cilat konsumatorët në përgjithësi i përdorin për të mbledhur informacione rreth suplementeve ushqimore. [10]. Për më tepër, përhapja e COVID-19 ka tërhequr më shumë klientë në platforma të gjera të tregtisë elektronike, duke i bërë shumë firma të suplementeve lehtësisht të aksesueshme për konsumatorët.

Tregu Global i suplementeve ushqimore


Tregu global i suplementeve ushqimore po rritet në mënyrë eksponenciale në shumicën e shteteve në Botë. Sipas të dhënave nga Anketa Kombëtare e Ekzaminimit të Shëndetit dhe Ushqimit (NHNES), për këtë treg ka pasur interes që nga vitet 1970 [1,89]. Shpërndarja gjeografike është shumë e ndryshueshme dhe është ndarë në gjashtë rajone kryesore [35,90]. SHBA, Evropa dhe Japonia zënë pjesën më të madhe të tregut të ndjekura nga Azia, Australia dhe Oqeania, të cilat të gjitha demonstrojnë për një zgjerim të tregut [8]. Lindja e Mesme dhe Afrika kanë pasur një rritje të shitjeve të suplementeve ushqimore, me në krye Afrikën e Jugut që mbetet tregu më i rëndësishëm [91]. Në Lindjen e Mesme, demografia dhe statusi socio-ekonomik i konsumatorëve, veçanërisht në Arabinë Saudite, ka çuar në zhvillimin e këtij tregu, i cili vlerësohet të arrijë në 875 milionë SAR deri në vitin 2021. [92]. Dallimet në këto shpërndarje gjeografike mund të vijnë si rezultat i disa faktorëve, siç janë karakteristikat socio-demografike dhe socio-kulturore, sjellja e konsumatorëve dhe popullsia në plakje.

Në nivel global tregu i suplementeve ushqimore u rrit nga 82 miliardë dollarë në 149.50 miliardë dollarë në vitin 2021. [10,37,88,93], dhe mendohet të rritet në afërsisht 308 miliardë dollarë në 2028, me një rritje vjetore të llogaritur prej 8.90% [94].



[Figura 11](#)

Shpërndarja gjeografike e tregut të suplementeve ushqimore dhe niveli i rritjes së tregut të suplementeve ushqimore në mbarë botën (I lartë, i mesëm dhe i ulët).



[Grafiku 1](#) Parashikimi i rritjes së madhësisë së tregut të suplementeve ushqimore për periudhën 2023-2028 [94].

Tregu i suplementeve ushqimore në SHBA dhe BE

Kërkesa për suplemente ushqimore u rrit ndjeshëm në SHBA gjatë pandemisë COVID-19.

Në vitin 2019, shitjet globale arritën në 345 milionë dollarë, një rritje prej 5% nga viti 2018, dhe multivitaminat mbetën kategoria më e shitur, me afro 120 milionë njësi të shitura [93]. Sondazhi i Këshillit të Përgjegjshëm të Ushqimit (CRN) raportoi një rritje prej 59, 44 dhe 37% respektivisht në përdorimin e multivitaminave, vitaminës C dhe vitaminës D në popullatën e Shteteve të Bashkuara të moshës ndërmjet 18 dhe 35 vjeç (47% meshkuj kundrejt 39% femra).

Për sa i përket tregut evropian, ai ka pësuar rritje të fortë që nga viti 2020 krahasuar me vitet e mëparshme (7.1 miliardë euro në 2015); pjesa vjetore u vlerësua të jetë 14.95 miliardë dollarë në 2019 dhe pritet të rritet me 9.3% duke arritur një vlerë prej 33.80 miliardë dollarë në vitin 2027 [88,95]. Shitjet e suplementeve ushqimore kaluan 1600 milion euro në Itali dhe 1 miliard euro në Rusi, ndërsa tregu ishte me vlerë më shumë se 100 milion euro në vende të tjera (përfshirë Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Poloninë, Norvegjinë, Finlandën, Suedinë, Belgjikën, Spanjën, Holandën dhe Hungarinë). Nga ana tjetër, në vende si Maqedonia, Gjeorgjia, Estonia dhe Danimarka, vlera e shitjeve varion nga 4.4 milionë euro deri në 98.7 milionë euro. [116,117].

Sipas një studimi të kryer në Shqipëri, më shumë se 87% e popullatës kanë marrë rregullisht suplemente ushqimore, gjatë pandemisë COVID-19. [116,117].

Në një studim tjetër i realizuar në vitin 2022 në Shqipëri mbi përdorimin e suplementeve ushqimore rezultoi në përfundimin se 85.9 % e popullatës së anketuar kishin pranuar se i njohin suplementet ushqimore, dhe 56.4 % i përdornin ato përveç dietës së tyre.

Nga ky studim rezultoi se qëllimi kryesor i përdorimit të suplementeve për konsumatorët shqiptarë rritja e energjisë (39 %) dhe përmirësimi i imunitetit (38,1%). Konsiderohet se qëllimi i dytë lidhet edhe me situatën pandemike të Covid-19. Ndër suplementet më të përdorura ishin vitamina C.

Pacientët informacionin mbi suplementet e merrnin kryesisht nga interneti (47.8%).

Prandaj në Shqipëri nevojiten herë pas here fushata informuese dhe ndërgjegjësuese për përdorimin e duhur të suplementeve ushqimore.

14.5 Ndikimi ekonomik i suplementeve ushqimore gjatë pandemisë COVID-19

Sektori i suplementeve ushqimore është një shtysë ekonomike në vendet ku suplementet ushqimore prodhohen, duke ofruar kështu një numër të konsiderueshëm vendesh pune me pagesë të lartë.

Industria punëson 750,000 amerikanë dhe gjeneron 5.75 miliardë dollarë taksa shtetërore në SHBA nga ky sektor. [98].

Faktorë të tillë si: evolucioni i çmimeve të suplementeve ushqimore, normat e prodhimit, kërkesa e konsumatorëve për shëndet dhe mirëqenie, efektiviteti, kërkimi shkencor në periudha të ndryshme, kriza shëndetësore e shkaktuar nga COVID-19, pasqyrojnë ndikimin e suplementeve ushqimore në sektorë të ndryshëm në përgjithësi dhe në ekonominë globale në veçanti [99,100].

Rekomandimet për të marrë suplementet ushqimore u rritën në momentin që pandemia COVID-19 shpërtheu dhe si rezultat dhe shitjet e tyre u rritën. Përveç kësaj, qarkullimi i gjeneruar nga suplementet ushqimore është rritur nga 4 miliardë dollarë në 1994 në 55.8 miliardë dollarë në 2020 [101]. Sipas Bayazid et al. [49], shitjet u rritën nga 101.38 miliardë dollarë në 2018 në afërsisht 220.3 miliardë dollarë në 2020.

Në të gjithë sektorët, kërkimi shkencor është një shtysë kryesore e produktivitetit, i cili është pjesë e rritjes ekonomike. Nëpërmjet hulumtimit nxitet kërkimi shkencor, i cili nxit përparimet teknologjike që rrisin produktivitetin. Prandaj, kërkimi shkencor është i lidhur me rritjen ekonomike sepse ndikon në progresin teknologjik dhe rrit ndërgjegjësimin e popullatës për efektet e suplementeve ushqimore, gjë që nga ana tjetër, rrit kërkesën e konsumatorit. [102,103]. Mbi 30,000 dhe 48,598 punime

shkencore mbi suplementet ushqimore janë të listuara respektivisht në bazat e të dhënave Scopus dhe PubMed.

Zhvillimi i kërkimit shkencor mbi produktet e shëndetit dhe mirëqenies u rrit ndjeshëm gjatë krizës shëndetësore të shkaktuar nga pandemia.

Tema 15

Çështjet Legjislative dhe Rregullatore mbi suplementet ushqimore

Prodhuesit e suplementeve ushqimore ndjekin një sërë udhëzimesh për të siguruar prodhimin e produkteve me vlerë reale. Organe të shumta rregullatore në mbarë botën zhvillojnë rregulla dhe standarte strikte dhe gjithëpërfshirëse për të garantuar efektivitetin e suplementeve dhe sigurinë e konsumatorit. Për shkak të kufizimeve që ndryshojnë nga vendi në vend, eksportimi i suplementeve ushqimore është sfidues, veçanërisht nëse rregulloret janë të paqarta ose produktet nuk janë përditësuar në përputhje me rregulloret e vendit importues ([Tabela 8](#)).

Tabela 8

Rregulloret/ligjet dhe kërkesat rregullatore të suplementeve ushqimore në vende të ndryshme (SHBA, BE, Kinë, Shqipëri dhe Algjeri) [[13](#),[118](#),[22](#)].

	SHBA	BE	Kinë	Shqipëria	Algjeria
Agjencia rregullatore	Administrata e Ushqimit dhe Barnave (FDA)	-Komisioni Evropian dhe autoritetet kompetente -EFSA (Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore), nëse zbatohen procedura të centralizuara	CFDA (Administrata e Ushqimit dhe Barnave e Kinës)	AKU (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit)	-
Rregullore dhe ligj	Akti FD & C (Akti Federal i Ushqimit, Barnave dhe	- -2002/46/EC	Rregullorja e Regjistrimit të Ushqimit	Ministria e Shëndetësisë Ligji Nr. 9323. (2004). Për barnat dhe shërbimin farmaceutik.	

	<p>Kozmetikës)</p> <p>-DSHEA (Akti për Shëndetin dhe Edukimin për Suplementet dietike)</p> <p>NLEA (Akti i Etiketimit dhe Edukimit të të ushqyerit)</p> <p>CGMP (Praktika aktuale e mirë e prodhimit: operacionet e prodhimit, paketimit, etiketimit për suplementet ushqimore)</p>	-EC Nr 1924/2006	<p>Shëndetësor</p> <p>Udhëzime për aplikimin e regjistrimit të ushqimit të shëndetshëm</p> <p>Udhëzuesi i punës për paraqitjen e ushqimit të shëndetshëm</p> <p>Standardi kombëtar i sigurisë ushqimore – ushqimet shëndetësore GB 16740-2014 [23]</p>	<p>Qendra e Publikimeve Zyrtare, Republika e Shqipërisë.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë Ligji Nr. 9323. (2004). Rregullorja e Regjistrimit. Qendra e Publikimeve Zyrtare, Republika e Shqipërisë.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë Ligji Nr. 105/2014. (2014). Për barnat dhe shërbimin farmaceutik. Qendra e Publikimeve Zyrtare, Republika e Shqipërisë</p>	
--	---	------------------	--	---	--

<p>Procesi i pajtueshmërisë/kompliancës</p>	<p>Prodhuesit dhe shpërndarësit janë përgjegjës</p> <p>Njoftimi/regjistrimi:</p>	<p>Njoftimi/regjistrimi</p>	<p>Regjistrimi: përdoren përbërësit jashtë fjalorit të lëndës së parë dhe të lëndëve ndihmëse</p>	<p>/</p>	
---	--	-----------------------------	---	----------	--

		Suplementet ushqimore që përmbajnë një përbërës të ri		Dosjet: përdoren përbërësit e listuar në fjalorin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse		
Kategoria	Ushqimet	+	+	+	+	+
	Barna	-	-	-	-	-
Regjistrimi i prodhuesit		-	+(I kufizuar)	+	NA	-
Prania e një liste pozitive		-	+	+	NA	NA
Praktika e mirë e prodhimit (GMP)		+	+(HACCP)	+	NA	NA
Provat klinike të produkteve individuale		-	+(Përbërës të rinj)	+(Përbërës të rinj)	NA	NA
Detyrohet të tregojë përdorimin dhe dozën		+	+	+	+	NA
Raportimi i ngjarjeve të rënda negative		+	+	-	+	NA
Etiketimi dhe paketimi		+	+	+	+	
Përshkrimi i formës		+	+	shpeshherë	+	NA
Kërkesat për reklamë		+	+	+	NA	

+/-: prania/mungesa e faktorit; NA: pa të dhëna.

15.1 Rregullorja e ndjekur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)

Akti Federal i Ushqimit dhe Medikamenteve i vitit 1906 ishte i pari i realizuar nga rregullorja federale në lidhje me ushqimin dhe barnat në SHBA, duke ofruar përkufizime të "falsifikimit" dhe "keqemërimit" dhe duke i dhënë qeverisë federale fuqinë për të penalizuar ata që prodhonin produkte të tilla [24]. Suplementi i parë ushqimor u shfaq në SHBA në vitin 1920, i përbërë kryesisht nga lëndë ushqyese dhe përbërës ushqimorë. [25]. Vite më vonë, nëpërmjet hartimit të ligjeve u rregullua prodhimi, përbërja, etiketimi dhe shpërndarja e tyre. Sot, suplementet ushqimore rregullohen nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave (FDA) përmes Aktit të Shëndetit dhe Edukimit të Suplementeve Ushqimore të vitit 1994 [26].

Një suplement ushqimor nuk synon të trajtojë, parandalojë ose kurojë sëmundje. Përgjegjësia kryesore e FDA-së është të sigurojë sigurinë dhe pastërtinë e suplementeve ushqimore pasi ato të tregtohen dhe të heqë nga tregu çdo produkt që mund të jetë potencialisht i rrezikshëm për konsumatorin. [25,27].

Që nga viti 1997, FDA ka ruajtur një listë të rregulloreve që rregullojnë praktikën e mira të prodhimit për suplementet ushqimore.

Rregulli përfundimtar "21 CFR pjesa 111" u botua në 2007 dhe përfshin praktikën e mira të prodhimit dhe shpërndarjes, etiketimit, paketimit dhe kërkesat për ruajtjen e të dhënave. Ndjekja e produktit për të verifikuar integritetin, cilësinë dhe sigurinë e tij nga procesi i prodhimit deri në shpërndarje është një komponent kyç i praktikave të mira të prodhimit. Në etiketën e suplementit duhet të bëhen pesë deklaratat:

E para ka të bëjë me identifikimin e produktit; një shtesë dietike duhet të etiketohet si "suplement ushqimor" ose të ofrojë një tregues të përbërësit(ve) që synojnë të plotësojnë dietën e dikujt. Së dyti, informacionin ushqyes që ka; Së treti emrin dhe adresën e prodhuesit, paketuesit ose shpërndarësit; Së katërti një deklaratë të përbërësve; dhe së pesti përmbajtjen e saktë.

Prodhuesit janë të detyruar me ligj të mbajnë një regjistër të të gjitha ankesave për ngjarjet e padëshiruara dhe të raportojnë ngjarjet e rënda negative tek FDA brenda 15 ditëve nga marrja e tyre. Një adresë ose një numër telefoni duhet gjithashtu të renditet në etiketat e suplementeve ushqimore, në mënyrë që çdokush të mund të raportojë një ngjarje të padëshiruar. Prodhuesve u kërkohet gjithashtu

të mbajnë shënime për të gjitha raportet e ngjarjeve të padëshiruara që marrin për një periudhë prej gjashtë vjetësh dhe t'i kenë këto të dhëna të disponueshme për rishikim nga FDA. [28,29]. Përveç kësaj, në SHBA, suplementet ushqimore nuk kanë nevojë për miratim para tregut, por prodhuesi duhet të garantojë që produktet janë të sigurt [13]. Për ta bërë këtë, informacioni mbi përbërësit dhe sigurinë duhet të jepet në mënyrat e mëposhtme: nëpërmjet procesit të njoftimit të përbërësve të rinj në një suplement. Shtimi i çdo përbërësi të ri në një suplement ushqimor duhet t'i prezantohet FDA-së 75 ditë para se suplementi të vihet në dispozicion në treg [29]; megjithatë, nëse një përbërës është përdorur në një produkt përpara vitit 1994, ai është i trashëguar dhe mund të vazhdojë të përdoret pa qenë nevojë që prodhuesi të njoftojë FDA-në. [30].

Në SHBA, më shumë se 50% e njerëzve marrin të paktën një suplemente ushqimor. Këto suplemente zakonisht synohen të merren vetëm nga goja dhe nuk mund të rekomandohen për përdorim në asnjë mënyrë tjetër administrimi [13]. FDA merr shumë raporte për ngjarje të padëshiruara si shtrimi në spital, reaksione alergjike, anomali kongjenitale etj.

Denham [31] raportoi se më shumë se 23,000 njerëz në SHBA vuajnë nga efektet negative të suplementeve ushqimore çdo vit. Pavarësisht rezistencës nga industria, FDA vazhdon të bëjë përpjekje të konsiderueshme për të vënë në fokus çështjen e sigurisë së suplementeve ushqimore [28].

15.2 Rregullorja e ndjekur në Bashkimin Evropian (BE)

Në Evropë suplementet ushqimore rregullohen nga Komisioni Evropian përmes disa direktivave. Komisioni Evropian ka vendosur rregullore në mbarë kontinentin për të mbrojtur konsumatorët dhe për t'u siguruar atyre ushqim dhe produkte të sigurt [34]. Megjithatë kuadri rregullator për suplementet ushqimore në Evropë ndjek legjislacionin e përgjithshëm të ushqimit dhe proceset e prodhimit të tyre i nënshtrohen procedurave të Praktikave të Mira të Prodhimit (GMP) dhe të Pikës Kritike të Kontrollit të Analizës së Rrezikut (HACCP). [35,36]. Për të garantuar integritetin dhe sigurinë e shtesave dietike dhe sigurinë e konsumatorëve, Komiteti Shkencor i Ushqimit (SCF), aktualisht Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA), ka vendosur marrjen e sipërme të tolerueshme (UTI) të mineraleve dhe vitaminave që mund të administrohen çdo ditë për të patur një shëndet të mirë [34].

Një shumëllojshmëri përbërësish ushqyes përveç vitaminave dhe mineraleve mund të përdoren në prodhimin e suplementeve ushqimore pasi ato të jenë miratuar nga organi rregullator (EFSA). Sipas Direktivave 2002/46/EC dhe 2001/15/EC, këto substanca mund të klasifikohen si aminoacide, enzima, prebiotikë dhe probiotikë, acide yndyrore esenciale dhe ekstrakte botanike. Përveç kësaj, nëpërmjet direktivave të lartpërmendura janë vendosur udhëzime uniforme për etiketimin e shtesave ushqimore dhe këto udhëzime përshkruajnë kërkesat për specifikimin e identitetit dhe përbërjes së suplementeve ushqimore [36].

Ndërkohë që vlera ushqyese e përbërësve të caktuar të një suplementi duhet të përshkruhet në etiketën e tij, gjithashtu edhe sasia e vitaminave dhe mineraleve apo përbërësve të tjerë, e ndjekur nga marrja maksimale e rekomanduar ditore, kushtet e ruajtjes dhe rreziku që lidhet me konsumimin e tepërt të produktit duhet të deklarohen. Gjithashtu suplementet ushqimore nuk duhet të deklarohen si preparate që kanë indikacione terapeutike ose t'u referohen dietave konvencionale. [37]

Tekstet legjislativ sipas Direktivës 1925/2006/KE ndalojnë apo përjashtojnë disa përbërës, të ndryshëm nga vitaminat dhe mineralet, që të shtohen në ushqime (duke përfshirë edhe suplementet ushqimore) që mund të kenë efekte të padëshirueshme për konsumatorët. Normalisht duhet të hartohet një listë e substancave të sigurta për të siguruar prodhimin dhe funksionimin e duhur të suplementeve ushqimore.

Ndërkohë, sipas Direktivës 2015/2283/KE, masa specifike legjislativ zbatohen për ushqimet e reja që nuk janë përdorur në Komunitetin Evropian përpara datës 15 maj 1997. Kjo direktivë ka çuar në krijimin e një liste të përshtatshme të përbërësve të rinj që mund të përdoren në prodhimin e suplementeve ushqimore për të siguruar aksesin e tyre në tregun e BE-së [13,37].

Për sa i përket tregut të brendshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Shëndetin dhe Mbrojtjen e Konsumatorit (DG-SANCO), e shoqëruar nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare dhe agjencia EFSA, monitorojnë dhe kontrollojnë tregun evropian të suplementeve ushqimore bazuar në Sistemin e Paralajmërimit të Shpejtë për Ushqimin dhe Bazat e të dhënave të ushqimit (RASFF), të cilat kërkojnë informacione të rëndësishme në lidhje me sigurinë ushqimore, duke përfshirë ushqimet funksionale, ushqimet e fortifikuara dhe suplementet dietike. Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se suplementet ushqimore nuk kërkojnë autorizim para tregtimit ose vlerësime paraprake të sigurisë [38,39]. Gjithashtu

Komisioni Evropian ka krijuar konceptin e njohjes reciproke për të siguruar lëvizjen e lirë të suplementeve ushqimore ndërmjet shteteve anëtare. Sipas këtij koncepti i ofrohet të gjitha produkteve të prodhuara ligjërisht në një shtet anëtar mundësia për t'u shitur pa kufizime në një shtet tjetër anëtar, edhe nëse këto produkte supozohet t'i nënshtrohen rregulloreve të ndryshme kombëtare. Aktualisht, disa shtete anëtare kërkojnë një shënim autorizimi për të vendosur një suplement ushqimor në treg [13].

15.3 Rregullorja e ndjekur në Shqipëri

